



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 57, Datë 31.03.2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË LARTË TË
PROKURORISË, NR 207, DATË 18.06.2021, “PËR PËRBËRJEN E KOMISIONEVE
TË PËRHERSHËM DHË ANËTARËT ZËVENDËSUES TË KËSHILLIT TË LARTË
TË PROKURORISË” I NDRYSHUAR**

Bazuar në nenin 149/a, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenin 159, pika 1, pika 2, germa i, nenin 160, pika 6 të Ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në Vendimin nr.414 datë 20.12.2021 “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nr. 207, datë 18.06.2021, “Për përbërjen e komisioneve të përhershëm dhe anëtarët zëvendësues të Këshillit të Lartë të Prokurorisë” si dhe në Vendimin nr.48 datë 10.03.2022 “Për një ndryshim në Vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë, nr. 207, datë 18.06.2021, “Për përbërjen e komisioneve të përhershëm dhe anëtarët zëvendësues të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, Këshilli i Lartë i Prokurorisë;

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr. 207, datë 18.06.2021, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, i ndryshuar bëhen ndryshimet si më poshtë:
 - Kryetari i Këshillit z. Alfred Balla zëvendëson z. Bujar Sheshi, si kryetar në Komisionin e Zhvillimit të Karrierës.
 - Anëtari i Këshillit z. Tartar Bazaj zëvendëson ish anëtarin z. Sandër Beci, si kryetar në Komisionin e Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet ne faqen zyrtare të Këshillit.
3. U shpall në Tiranë, sot më datë 31.03.2022.

KRYETARI

ALFRED BALLA

